

## STATUTI

### I QËNDRËS "SUADA"

#### Neni I – THEMELIMI, KOHËZGJATJA, SELIA

Është themeluar sipas vendimit nr.4, datë 10.10.2017 i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA) dhe udhëzimit nr. 663 datë 10.10.2017 i Ministrit të Kulturës, Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit – SUADA, e quajtur këtu e në vijim Qendra “SUADA”, e cila është një organizatë jofitimprurëse në formën e qendrës, pa anëtarësi, me kohëzgjatje të pakufizuar dhe me adresë primare në Rr. Andon Zako Cajupi, Tiranë, Shqipëri.

#### Neni II - OBJEKTI DHE QËLLIMI

Objekti i kësaj qendre është:

- a) Kryerja e aktiviteteve promovuese dhe fushatave të ndërgjegjësimit për njohjen dhe respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në Republikën e Shqipërisë;
- b) Të kryejë promovimin e vlerave të krijimtarisë intelektuale dhe artistike, edukimin e brezave të reja si dhe cdo veprimtari tjeter në funksion të mbrojtjes së të drejtës së autorit në Shqipëri.
- c) Kryerja e funksionit të mbledhjes të tarifave të shpërblimit nga përdorimi i veprave të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet përdorues, si një sportel i vetëm në emër të të gjitha agjencive të administrimit kolektiv të licencuara, si dhe shpëndarjen e këtyre të ardhurave tek këto agjenci në përputhje me ligjin 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura”, udhëzimin nr. 663 datë 10.10.2017 i Ministrit të Kulturës “Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv”, vendimin nr. 4, datë 10.10.2017 të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit.
- ç) Kryerja e të gjitha veprimeve dhe aktiviteteve për zbatimin e parashikimeve të këtij neni.

Qëllimi kësaj qendre është:

- a) të kryejë aktivitete formuese edukimi dhe sensibilizimi duke ofruar edhe konsulencë të specializuar për të tretët;
- b) të krijojë logistikën dhe infrastrukturën e nevojshme me synim kryerjen e veprimtarisë së kësaj qendre.
- c) të përfaqësohet në organizata apo ente publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare, për bashkëpunim reciprok dhe intensifikimin e eksperiencave dhe praktikave me të mira të fushës;
- c) të publikojë studime, broshura, libra dhe revista, të cilat kontribuojnë në sensibilizimin e grupeve të interesit dhe subjekteve përdorues mbi kuadrin rregullator të të drejtave të autorit në Shqipëri;

### Neni III – PASURIA

Pasuria fillestare e qendrës është në vlerën prej 1 (një) mijë lekë, të derdhura në llogari bankare nga personi i autorizuar për regjistrimin e Qendrës.

Ajo gjithashtu do të përbëhet nga pagesat për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, kontributet e themeluesve të saj ose të tretëve, nga kontributet ose subvencionet e Enteve Publike ose Private shqiptare dhe të huaja, nga dhurimet, kuotat, akte të vullnetshme dhe dhuruese, nga të ardhura që vijnë si rezultat i shitjes së botimeve të Qendrës, ose nga aktivitete të tjera në mbështetje të Qendrës, si dhe çdo fitim, me çdo mënyrë të ligjshme, të pasurive të luajtshme, të paluajtshme si dhe burime të tjera.

### Neni IV– THEMELUESIT

Subjekt themelues i Qendrës “SUADA” janë personat juridikë si më poshtë vijon:

- Shoqata “Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve”, e përfaqësuar nga Presidenti i saj Z. Zamir Sukniqi, me adresë Rr. Andon Zako Çajupi, Tiranë.
- Shoqata “ALBAUTOR” e përfaqësuar nga Drejtori i saj Z. Erlir Puto, me adresë Bulevardi “Bajram Curri”, nr. 114, katë 2, Tiranë.

### Neni V - ORGANET DREJTUESE TË QENDRËS

1. Bordi i Drejtorëve;



2. Drejtori Ekzekutiv.

**Neni VI - PËRBËRJA E BORDIT TË DREJTORËVE**

1. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha Agjencive të Administrimit Kolektiv (AAK) të licencuara (emërtuar në udhëzimin e Ministrit të Kulturës nr.663, datë 10.10.2017 si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës).
2. Bordin e Drejtorëve e drejton, në mënyrë simbolike, përfaqësuesi i AAK-së më të parë të themeluar në administrimin kolektiv në Shqipëri.

**Neni VII - KOMPETENCAT E BORDIT TË DREJTORËVE**

Bordi i Drejtorëve ka këto kompetenca:

- a) përcaktimin e fushave dhe programeve të qendrës;
- b) irregullat e zbatimit të programeve që parashikohen më sipër;
- c) miratimin e rregullores së brendshme;
- d) të mbikëqyrë funksionimin e qendrës SUADA;
- e) metodologjinë e raportimit tek Bordi i Drejtorëve pjesë të Qendrës SUADA;
- f) mënyra kur dhe si do të bëhen transfertat në llogaritë përkatëse;
- g) afatin kohor të transferimit të shumave të mbledhura në llogari të secilës Agjenci të licencuar në mënyrë periodike gjatë vitit finanziar.

**Neni VIII - BORDI I DREJTORËVE**

**MËNYRA E THIRRJES DHE MBAJ TJES SË MBLEDHJEVE**

1. Bordi i Drejtorëve i Qendrës SUADA përbëhet përfaqësuesit e Agjencive të Administrimit Kolektiv të licencuara dhe thirret nga përfaqësuesi i Agjencisë drejtuese të Qendrës SUADA, të paktën një herë në vit, brenda muajit mars të çdo viti, dhe në çdo moment për nevoja të posaçme ose kur e kërkon  $\frac{1}{4}$  e anëtarëve të Bordit. Bordi i zhvillon mbledhjet e irregullta kur janë të pranishëm të paktën  $\frac{3}{4}$  e anëtarëve të tij.
2. Bordi i Drejtorëve thirret nëpërmjet një lajmërimi, dërguar me letër të thjeshtë të paktën 5 ditë para ditës së mbledhjes dhe i drejtohet të gjithë anëtarëve të Bordit. Lajmërimi duhet të përbajë rendin e ditës që do të diskutohen, si dhe të jetë detyrimisht i regjistruar në protokollin e Bordit.

3. Bordi konsiderohet i thirrur rregullisht, edhe në rastet kur nuk zbatohen formalitetet për të cilat flitet në paragrafin “1” dhe “2” më sipër, në qoftë se janë të pranishëm të gjithë anëtarët.
4. Mbledhjet e Bordit mbahen në selinë e Qendrës SUADA ose në ndonjë vend tjetër të ndryshëm nga selia, në Shqipëri.

## Neni IX – DREJTORI EKZEKUTIV

### TË DREJTAT E PËRFAQËSIMIT DHE FIRMËS


1. Qendra SUADA do të përfaqësohet nga Agjencia e Administrimit Kolektiv e përzgjedhur si drejtuese, përcaktuar me këtë funksion në vendimin nr. 4, datë 10.10.2017 i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA);
2. Përfaqësuesi i Agjencisë së Mbrojtjes së Producentëve (AMP) sipas vendimit nr.4, datë 10.10.2017 i KKDA-së, është Drejtor Ekzekutiv i Qendrës SUADA.
3. Drejtori përfaqëson qendrën SUADA para të tretëve si edhe të drejtën për të firmosur çdo akt që ka të bëjë me administrimin, në emër të Qendrës SUADA, në të gjithë territorin kombëtar dhe jashtë tij.
4. Drejtori përfaqëson Qendrën SUADA, duke nënshkruar në emër të saj të gjithë aktet me përbajtje ekonomike dhe të natyrës administrative dhe kontabël.
5. Drejtori mban përgjegjësi për mbledhjen e të ardhurave të Qendrës SUADA, me çdo mënyrë të ligjshme, nga subjekte publike apo private, shqiptare ose të huaja, me të drejtën për të lëshuar autorizimin përkatës;
6. Drejtori mban përgjegjësi për pagesën, në para, me transfertë ose çek bankar qarkullues ose postal, të shumave që do t'i u kalohen AAK-ve të licencuara, në çdo mënyrë të ligjshme, sipas objektit të tyre, me detyrimin për të kërkuar deftesën ose faturën përkatëse;
7. Drejtori kryen çdo lloj operacioni tjetër bankar, që ka të bëjë si me mbledhjen e tarifave të shpërblimit ashtu edhe me përdorimin e fondeve në emër të Qendrës SUADA;
8. Drejtori është përgjegjës për rekrutimin e stafit administrativ të qendrës SUADA si dhe për delegimin e shërbimeve, rast pas rasti, me natyre juridike dhe ekonomike, tek subjektit të treta në bazë të kontatave përkatëse;
9. Drejtori nëpërmjet administratës së qendrës SUADA kryen hartimin dhe miratimin e dokumentave për entet publike apo private, dhe në veçanti, bilancin vjetor financiar;

4

10. Drejtori nëpërmjet administratës së qendrës SUADA harton dhe miraton çdo dokument tjeter të karakterit administrativ, kontabël ose fiskal, të kërkuar nga organet publike ose private.
11. Drejtori mund të delegojë tek persona të tjerë përbushjen e disa detyrave specifike të funksionimit të Qendrës SUADA duke u dorëzuar atyre prokurën e nevojshme për të nënshkruar në emrin e tij.
12. Drejtori i zbaton çdo akt me fuqi ligjore dhe nenligjore të organeve kompetente publike për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të kësaj qendre.

#### NENI X - SEKRETARI

1. Sekretari përzgjidhet nga Drejtori i Qendrës .
2. Sekretari i qendrës, kujdeset për njofimin e mbledhjeve, dërgimin e lajmërimeve.
3. Sekretari kujdeset per mbajtjen e procesverbaleve, librin e protokollit dhe kryen çdo funksion tjeter që i delegohet nga Drejtori.



#### NENI XI - BILANCI DHE KONTABILITETI

1. Viti finanziar i Qendrës fillon më 1 janar dhe mbyllt më 31 dhjetor të çdo viti.
2. Çdo vit, brenda 20 Nëntorit, Drejtori garanton hartimin dhe depozitimini e bilancit.
3. Në fund të çdo viti finanziar, Drejtori do të sigurojë raportin mbi ecurinë e drejtimit të Qendrës.
4. Bilanci përfundimtar i vitit të shkuar, hartohej brenda muajit Janar të secilit vit kalendarik dhe depozitohet pranë Ministrisë së Kulturës.

#### NENI XII - DISPOZITAT TË FUNDIT

Qendra SUADA, për sa nuk është parashikuar shprehimi i shërbimit në këtë Statut, zbaton dispozitat e ligji 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura", udhëzimit nr. 663 datë 10.10.2017 i Ministrit të Kulturës "Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv", vendimit nr.4, datë 10.10.2017 " Për transferimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërbimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to drejt njërsë prej agjencive të administrit të sportelit unik për

5

administrimin e të drejtës së autorit – SUADA” si dhe legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.


Lexuar, pranuar dhe nënshkruar

Tiranë, më 20/10/2017

**THEMELUESIT**

**Shoqata “Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve”**

President Zamir Sukniqi



**Shoqata “ALBAUTOR”**

Drejtori Erlir Puto

